

**AKT I THEMELIMIT**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“DIGITAL ROOTS” SHPK**

Sot, në datën 27/03/2024 (dymijë e njëzetëtre) personat e poshtëshënuar :

1. **Elias Mazloum**, atësia Assaad, i datëlindjes 07. 07.1983, lindur në Liban, banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i dokumenti pasaportë Nr. LR3231165 ;
2. **Armida Alikaj**, atësia Ferik, e datëlindjes 13. 07.1979, shtetase shqiptare, banuese në Tiranë, madhore, me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse e dokumentit pasaportë Nr BD1397594 dhe nr.personal H95713054S;
3. **Eva Rama**, atësia Kujtim, e datëlindjes 22.11.1976, shtetase shqiptare, banuese në Tiranë, madhore, me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse e dokumentit ID Nr.036536250 dhe Nr.Personal H66122123V

në cilësinë e "Ortakëve Themelues", me vullnet të lirë të plotë e të sinqertë, dhe inisiativën e lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërise, Kodin Civil në fuqi, ligjin Nr. 9901, datë 04.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kanë vendosur të nënshkruajnë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, (më poshtë "Shoqëria"), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e kësaj kontrate, së cilës i bashkëngjitet (më poshtë "Shtojca 1").

**Neni 1 – Emërtimi**


Emërtimi i Shoqërisë është "**DIGITAL ROOTS**" Sh.p.k.

**Neni 2 – Selia**

- 2.1 Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: **Rruga “Mujo Ulqinaku”, Pall.5 (mbrapa Kishës Katolike), 1001 Tiranë, Shqipëri.**
- 2.2 Gjatë veprimtarisë së saj, shoqëria ka të drejtë të krijojë dhe hapë degë, filiale dhe/ose zyra përfaqësimi edhe në qytete të tjera, brenda dhe/ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërës, në përputhje me legjislacionin e kërkuar në fuqi sipas juridikzionit të vendit përkatës.

**Neni 3 - Kohëzgjatja**

- 3.1 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një afat të pakufizuar, me përjashtim të rastit kur Asambleja e Ortakëve, sipas kuorumi të përkatës vendos ndryshe.



- 3.2 Shoqëria "**DIGITAL ROOTS**" sh.p.k gjëzon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti i regjistrimit si e tillë në regjistrin tregtar të QKB-së.

#### **Neni 4 – Objekti i veprimtarisë**

- 4.1 Shoqëria "**DIGITAL ROOTS**" sh.p.k ka si objekt të veprimtarisë të saj, zhvillimin e aktiviteteve si më poshtë të përcaktuara:

- a) **Arsimi nëpërmjet praktikës:** Ofrimi i trajnimeve praktike në aftësitë dixhitale përmes programeve të praktikës; - Ofrimi i mundësive për të rinxjtë për të mësuar dhe punuar njëkohësisht, duke fituar përvojë të vlefshme në botën reale.

**Mundësi punësimi në distance:** Lidhja e praktikantëve të trajnuar me vende pune të paguara mirë në distancë në fushat dixhitale; Reduktimi i nevojës së të rinxjeve për të migruar në zonat urbane duke ofruar mundësi punësimi në nivel lokal.

**Teknologjia dhe dixhitalizimi:** Përqendrimi në përdorimin e teknologjisë për arsimim dhe punësim.; Theksimi i strategjive të dixhitalizimit për të pajisur të rinxjtë me aftësitë përkatëse për epokën dixhitale.

**Marketing dhe Zhvillimi i Biznesit:** Ofrimi i trajnimeve dhe mbështetjes në marketingun dixhital, kontabilitetin, paraqitjen dhe aftësi të tjera të lidhura me biznesin; Fuzizimi i të rinxjeve me njohuri dhe mjete për të pasur sukses në ndërmarrjet globale dhe SME-të.

**Lehtësimi i Nomadëve Dixhitalë dhe Turizmit Dixhital:** Përdorimi i platformave dixhitale dhe strategjive të marketingut për të térhequr nomadët dixhitalë dhe për të nxitur turizmin dixhital;

**Përfshirja e drejtpërdrejtë në energjinë e gjelbër,** teknologjinë inteligjente, ekonominë qarkulluese dhe efikasitetin e energjisë: Partneritet me kompani dhe organizata të energjisë së gjelbër për të trajnuar praktikantët në teknologjitet dhe praktikat e energjisë së rinovueshme;

Edukimi dhe avokimi për masat e efikasitetit të energjisë në operacionet dixhitale dhe të biznesit

- b) Ofrimi i shërbimeve gjithëpërfshirëse të marketingut në internet, duke përfshirë, por pa u kufizuar në optimizimin e motorëve të kërkimit (SEO), marketingun e mediave sociale, krijimin e përbajtjes dhe zhvillimin e faqeve në internet, që synojnë të ndihmojnë bizneset të përmirësojnë praninë e tyre dixhitale dhe të arrijnë audiencën e synuar në mënyrë efektive. Konsulencë biznesi, nepermjet ofrimit te sherbimeve te tillë: zhvillim projekti; menaxhim projekti; analize dhe menaxhim rishku; ristrukturime dhe riorganizime financiare te shoqerive/ndermarrjeve; sherbime perkthimi; auditime te performances dhe certifikimi i standardeve te cilecise; struktura biznesi; zhvillime planesh biznesi; plane marketingu; fushata marketingu.

- c) Shoqëria mund të kryejë çdo operacion tregtar, operacione që lidhen me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, financiare dhe kreditore si dhe të blejë apo shesë apo të marrë apo japë me qira pasuri, si dhe të ketë interesa apo pjesëmarrje në shoqëri, ente,

konsorciume, të themeluara apo në themelim e sipër, që kanë një objekt të ngjashëm apo funksional në arritjen e qëllimeve të Shoqërisë, si dhe të ofrojë garanci, *fideiustione*, të marrë hua dhe ofrojë garanci, pasurore apo personale, në favor të të tretëve.

- 4.2 Gjithashtu shoqëria mund te ushtroj edhe çdo lloj aktiviteti tjeter te pashprehur më sipër, që lejohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

### **Neni 5 – Kapitali themeltar**

5.1 Kapitali fillestar themeltar i shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) LEK.

5.2 Kapitali i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ndahet në një numër kuotash, në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri. Çdo ortak zotëron një kuotë të vetme në shoqëri.

### **Neni 6 - Kontributet**

- 6.1 Pjesëmarja e themeluesve në kapitalin bazë të shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre si më poshtë:

1. Ortaku themelues **Elias Mazloum**: Pronar i 1(një) kuote me vlerën e përgjithshme të 70,000 lek që përbën 70 % të kapitalit themelor të shoqërisë;
2. Ortaku themelues **Armida Alikaj**: Pronar i 1 (një) kuote me vlerën e përgjithshme të 20,000 që përbën 20% të kapitalit themelor të kompanisë;
3. Ortaku themelues **Eva Rama**: Pronar i 1 (një) kuote me vlerën e përgjithshme të 10,000 që përbën 10% të kapitalit themelor të kompanisë.

- 6.2 Kontributi i ortakëve mund të jetë në para të gatshme ose në natyrë (pasuria e luajtshme pasuria e paluajtshme ose të drejtat).

### **Neni 7 Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar**

- 7.1 Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar 3/4(tre të katërtat) të votave të ortakëve në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit, por pa cënuar përqindjen në kontribute të ortakëve që zotërojnë më pak se 10 % të kapitalit.

- 7.2 Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar te shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave 3/4(tre të

katërtat) në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit, duke pasur parasysh që të respektohet minimumi i parashikuar nga Ligji për Shoqëritë Tregtare.

## **Neni 8**

### **Kuotat dhe Kalimi i Kuotave**

- 8.1 Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim ndërmjet palëve.
- 8.2 Transferimi i kuotave të ortakëve të shoqërisë brenda ortakërisë apo në drejtim të personave të tretë jashtë ortakërisë është i kushtëzuar në çdo rast nga ushtrimi i të drejtës së parablerjes në favor të ortakëve ekzistues.

Ortaku, para se t'i transferojë në çdo formë kuotat e veta një ortaku ekzistues brenda shoqërisë apo një personi të tretë jashtë saj, detyrohet të njoftojë me shkrim paraprakisht të gjithë ortakët ekzistues nëse dëshirojnë të blejnë kuotat me të njëjtat kushte ekonomike si dhe në mënyrë përpjestimore sipas kuotave që zoterojnë në kapital të shoqërisë.

Në rast se, të gjithë ortakët nuk përgjigjen me shkrim brenda 20 ditëve nga njoftimi apo deklarojnë se nuk dëshirojnë të blejnë kuotat, ortaku është i lirë të transferojë kuotat e tij terësisht apo pjesërisht në drejtim të personave të tretë jashtë ortakërisë.

Në rast se një pjesë e ortakëve ekzistues përgjigjen me shkrim brenda 20 ditëve dhe deklarojnë se dëshirojnë të blejnë kuotat, ortaku është i detyruar ti transferojë kuotat e tij në drejtim të tyre në mënyrë të barabartë (dmth në rast se dy ortakë shprehin dëshirën për blerjen e kuotave, ato do t'u shiten të dy ortakëve në mënyrë të barabartë, pra 50% seicilit).

## **Neni 9**

### **Emërimi i Administratorit**

- 9.1 Me këtë akt emërohet Administrator i Vetëm i Shoqërisë personi i mëposhtëm:  
Z. Elias Mazloum, atësia, i datëlindjes Assaad, lindur në Liban, madhore, me zotësi të plotë për të vepruar, rezident shqiptar mbajtëse e leje qëndrimit nr. personal **për një afat 5 vjeçar, nga momenti i regjistrimit të këtij akti pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.**
- 9.2 Administratorit të Vetëm i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të gjitha formalitetet e parashikuara për themelin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, Administratori i Vetëm, mund t'i drejtohet për ndihmë të tretëve ose konsulentëve të cilëve mund t'i delegojë në tërsi ose pjesërisht kryrjen e aktivitetit të sipërpërmendur.
- 9.3 Administratori i Vetëm është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor - Tiranë. Ai është gjithashtu i autorizuar, të firmosë të gjitha aktet dhe të marrë




përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj pranë kësaj Gjykate si edhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tij personave të tjera

### ORTAKËT THEMELUES

Elias Mazloum



Armida Alikaj



Eva Rama

